# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-474606**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Aleksandër Vuçiç jep dorëheqjen si president i Serbisë, ua lë “amanet” serbëve: Mos hiqni dorë kurrë nga Kosova! |
| ADRESA | `https://newsbomb.al/rajon/aleksander-vucic-jep-doreheqjen-si-president-i-serbise-ua-le-amanet-serbev-i402147` |
| BURIMI | newsbomb.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 18:48:01 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 18:43:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `7401c7a7a6813731877a3a09cfb84c6aba989722925112d9c78197176b2daff7` |
| TEKSTI | `a7b13dc45fa6ef3faab2bf90a4ea8bcc595ed253ba0fbde4b301156ceff2fb81` |
| PAMJA | `7b3354d149bc02c5d6674e59bfe1e92911b7d6b5fae95fee85786fdfab9beb04` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `2f768a7b18882f54ba8f743b1217897bb5e5f9b0909e37b742ced2d79fe50af7` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `67690963e34eac89a6c1ba46d066d36b47b728bdbf8bf8d029d400ef1ab927ee` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/2f768a7b18882f54ba8f743b1217897bb5e5f9b0909e37b742ced2d79fe50af7`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Hapësire reklamuese



Rajoni

27 Shtator 2026, 20:43

# Aleksandër Vuçiç jep dorëheqjen si president i Serbisë, ua lë "amanet" serbëve: Mos hiqni dorë kurrë nga Kosova!

Shkruar nga **Newsbomb**



Aleksander Vucic

Aleksandër Vuçiç ka dhënë dorëheqjen nga posti i presidentit të Serbisë, duke i hapur rrugë përfshirjes së tij në garën e ardhshme parlamentare si qytetar i zakonshëm. Dorëheqja, e paralajmëruar prej tij, u formalizua mbrëmjen e sotme në Presidencën serbe, pak pasi Vuçiç iu drejtua publikut.

Në fund të fjalës së tij, presidenti serb u ndal te një prej çështjeve më të ndjeshme të politikës së Beogradit: Kosovën. Vuçiç u bëri thirrje qytetarëve serbë që të mos tërhiqen nga kërkesat e tyre për Kosovën, duke e vendosur këtë çështje mes sfidave me të cilat sipas tij Serbia do të duhet të përballet edhe pas largimit të tij nga Presidenca.

*"Do të duhet të mbrojmë popullin tonë në Kosovë dhe Metohi dhe të mos lejojmë ata që do të përpiqen t'i bindin të gjithë që të heqim dorë sa më shpejt nga Kosova, me arsyetimin se kështu nuk do të shohim më nga e kaluara, por nga e ardhmja. Të gjithë do të duhet t'i rezistojnë kësaj. Qytetarët le të mendojnë vetë"*, tha Vuçiç.

Ai e lidhi të ardhmen e Serbisë edhe me zhvillimin ekonomik, teknologjinë dhe vazhdimin e rrugës drejt Bashkimit Evropian, ndërsa theksoi nevojën për ruajtjen e marrëdhënieve me aleatët tradicionalë të Beogradit në Lindje.

Këshilluar për ty

Revista




Abonohu tani dhe lexoje

## Lajmet e fundit



Aktualitet
E dhimbshme në Fier, i moshuari i paralizuar nuk arrin të dalë dot nga shtëpia që po i digjej, gjendet i vdekur nga zjarrfikësit (EMRI)



Politikë
Rokadë në diplomacinë shqiptare, Meidani dhe Malaj pritet të ndërrojnë postet mes Shkupit dhe Prishtinës

Zbulo më shumë artikuj



**Fjalimi i fundit si president, Vuçiç i drejtohet serbëve: Faleminderit që qëndruat pranë vendit tuaj**

*"Do të duhet të mbrojmë popullin tonë në Kosovë dhe Metohi dhe të mos lejojmë ata që do të përpiqen t'i bindin të gjithë që të heqim dorë sa më shpejt nga Kosova, sepse kështu, sipas tyre, nuk do të shohim më nga e kaluara, por nga e ardhmja. Prandaj, të gjithë do të duhet t'i rezistojnë kësaj. Qytetarët le të mendojnë vetë. Do të duhet të vazhdojmë zhvillimin ekonomik, por kur flasim për zhvillimin ekonomik, do të duhet të kujdesemi për inovacionin, inteligjencën artificiale dhe robotët, që të mos mbetemi pas.*

*Një herë jua kam treguar këtë. Kur isha në Paris, ata amerikanë që zotërojnë kompanitë më të mëdha satelitore në botë më thanë: 'Jemi pesë ose gjashtë muaj përpara kinezëve'. Nuk e di, por ajo garë është shumë e pasigurt. Por, siç më thanë, pesë ose gjashtë muaj në këtë biznes, në një epokë kur vendimet merren shpejt dhe gjërat ndryshojnë me shpejtësi, janë shumë. Kur pyeta se sa prapa jemi ne evropianët, më thanë: 'Shtatë deri në tetë vjet'. Atëherë shikoni vetë se sa prapa jemi. Dhe për këtë arsye Serbia, duke vazhduar rrugën e saj evropiane dhe duke u kujdesur për miqtë e saj tradicionalë në Lindje, do të duhet të zhvillohet ekonomikisht edhe më shpejt"*, tha Vuçiç.

Vuçiç nënshkroi letrën e dorëheqjes në Presidencën serbe, pasi iu drejtua publikut. Ai deklaroi se synon të marrë pjesë në zgjedhjet e ardhshme parlamentare si një qytetar i zakonshëm, duke e zhvendosur kështu aktivitetin e tij politik në një tjetër fazë.

## Sondazh

Poll


## Lexo gjithashtu




E Diel 20:07

# Fjalimi i fundit si president, Vuçiç i drejtohet serbëve: Faleminderit që qëndruat pranë vendit tuaj





Rajoni

Erdogan i kundërpërgjigjet

Rajoni

E veçanta e protestës së 10, në ekran

Netanyahu pas akuzë për "diktator": Vendi i kriminelëve të luftës është në gjykatë

E Shtunë 19:59

shfaqen Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli: Jemi shumë krenarë për atë që kemi bërë për popullin (VIDEO)

E Premte 23:41 Newsbomb




E Enjte 16:26

## Çfarë dihet për zhdukjen e Behajdin Allaqit dhe çfarë konstatoi Gjykata Speciale



Rajoni

44-vjeçarja përjeton TMERR, burri e mbyll në shtëpi dhe e kërcënon me th*kë për tre orë, thuhet se dyshja vuan nga shëndeti mendor (DETAJE)

E Mërkurë 21:38 Newsbomb



Rajoni

"Jo në emrin tim!" Shqiptarët mblidhen për të tetën herë në Prishtinë, sonte do të mbahen fjalime nga figura të njohura (EMRAT-DETAJE)

E Mërkurë 18:03 Newsbomb




E Mërkurë 09:39

## FOTO-LAJM/ Vjosa Osmani takon ish-presidentin Bill Clinton në pritjen e "Clinton Global Initiative"







Rajoni

Kaja Kallas takime "kokë më kokë" me Kurtin e Vuçiç: Normalizimi i marrëdhënieve duhet çuar përpara

E Mërkurë 07:22



Rajoni

Shqiptarët mbushin Prishtinën prej një jave, Endrit Thaçi del me MESAZH: Shtatë ditë zë, qëndresë dhe vendosmëri (PAMJE)

E Martë 23:38 Newsbomb

Rajoni



E Martë 21:27

## Autopsia për vrasjen e 25-vjeçares në Greqi, detaje tronditëse: Penelope u vra pas shpine, 15 goditje me thikë



Rajoni

"Si u bë rrëfimi i Albin Kurtit baza e dënimit për Hashim Thaçin në Hagë?", Lirim Mehmetaj: Dënuan krerët e UÇK-së për rastin e Behajdin Allaqit pa asnjë provë

E Martë 20:33



Rajoni

Një javë në shesh për lirimin e çlirimtarëve, djali i Hashim Thaçit falenderon publikisht shqiptarët: Ju na motivoni të vazhdojmë betejën ligjore (REAGIMI)

E Martë 18:36 Newsbomb

Rajoni




E Hënë 22:47

# Hashim Thaçi u bëri të fala nga Haga, mijëra qytetarë mbushin sërish sheshin “Skënderbeu”: President, ta kemi dëgjuar zërin

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.